

SKANIM I PERFORMANCËS SË LARTË ME LIDHJE PRAKTIKE NË RRJET



Ideal për biznese të të gjitha përmasave, skaneri kompakt "imageFORMULA DR-S150" ofron lidhje praktike USB dhe rrjeti, si dhe një ekran LCD me ngjyra dhe prekje, për përdorim të lehtë e intuitiv.

Përfitimet

- **Produktivitet i lartë** skanim me ngjyra deri në 90 ipm dhe vetëmbushëse e madhe 60-fletëshe
- **Opsione lidhjeje praktike** me LAN, Wi-Fi dhe USB drejt kompjuterëve dhe pajisjeve inteligjente
- **Përdorim i lehtë** duke përdorur ekranin e madh me prekje dhe ngjyra, dhe funksionin e skanimit të drejtuar e të drejtpërdrejtë në rrjet
- **Model robust** për ngarkesa deri në 4000 skanime/ditë
- **Vetëprocesim inteligjent** me njohje germash, barkodesh, kodesh 2D
- **Administrim elastik dhe koherent** për një larmi të gjerë dokumentesh, duke përfshirë dhe pasaportat e letërnjoftime
- **Kosto të ulura informatike dhe operative** me menaxhim të centralizuar skaneri dhe profile përdoruesish
- **Siguri e fortë** me hyrje të thjeshtë me kod 4-PIN dhe mënyra të ndryshme për autentikimin e përdoruesve
- Programi **CaptureOnTouch Pro** për funksione të lehta, por të fuqishme, regjistrimi, procesimi dhe integrimi
- **Integrim i personalizuar** nëpërmjet SDK-ve të lidhura me module

DR-S150

SHPEJTËSI NË
BARDHEZI DHE ME
NGJYRA
45 PPM / 90 IPM

VOLUMI I
KËSHILLUAR DITOR
4000 SKANIME/DITË

VETËMBUSHËSJA
E DOKUMENTEVE
ME 60 FLETË

LIDHJE
NDËRFAQEJE ME
USB, LAN OSE WIFI

imageFORMULA DR-S150

Njihuni me skanimin e shpejtë, të qëndrueshëm e të performancës së lartë, me funksionim të lehtë, përmes ekranit me ngjyra, me prekje. Opsionet e ndërfaqes LAN, Wi-Fi ose USB mundësojnë lidhje fleksibël, për përdorim komod në të gjitha llojet e aplikacioneve dhe të konfigurimeve.

LIDHJE

Për përdorim praktik kudo që të ndodhet në zyrë apo në pika me klientelë, DR-S150 lidhet si me kablllo ashtu edhe me valë me rrjetin apo në formën klasike me kompjuterin përmes USB. Dokumentet mund të skanohen drejtpërdrejt nga ekranit me prekje ose duke përdorur kompjuterin apo pajisjen tuaj inteligjente.

PRODUKTIVITET I LARTË, PËRMASA TË VOGLA

DR-S150 integrohet më së miri në ambientet me ngarkesë pune dhe shumë përdorues, si dhe në ambiente ku ka klientelë. Përmasat kompakte i lejojnë të vendoset në pika ku hapësira është me kursim. Pajisja mbështet skanim të shpejtësisë së lartë me ngjyra prej deri 90 figura në minutë dhe mund të skanojë në grupe 60-fletëshe me një komandë të vetme. Ajo përballon dhe ngarkesa të larta prej deri 4000 skanime në ditë, duke e bërë të besueshme dhe të qëndrueshme për një larmi punësh.

MBUSHJE E QËNDRUESHME DHE FLEKSIBËL

Skani dokumente të tipave të ndryshëm, me mbushje të qëndrueshme dhe ndarje të ruleve për ta bërë më të lehtë skanimin e tipave të kombinuar të dokumenteve. Mund të skanoni një larmi dokumentesh, nga të hollë e të trashë deri te letërnjoftimet plastike, kartat me relief dhe deri dhe pasaportat. Me pikasjen me ultratinguj të mbushjeve dyshe, mund të qëndroni të sigurt se skanohen të gjitha dokumentet dhe asnjë informacion nuk mbetet pa u marrë

EFIKASITET


Me mbështetjen për skanim me një prekje, mund të parakonfiguroni punët për t'i kryer me prekjen e një butoni në ekranin e madh LCD me ngjyra dhe prekje. Përdoruesit mund t'i dërgojnë skanimet e tyre pa vështirësi drejt destinacioneve të ndryshme dhe me funksionin e skanimit të drejtuar "PUSH Scan" mund t'i dërgoni figurat drejtpërdrejt në destinacionin e synuar pa i kaluar nga lidhje me kompjuterin.

CILËSI E OPTIMIZUAR FIGURE

Me përdorimin e modalitetit "Active Threshold" dokumente të ndryshme, qofshin këto me shkrim të zbehtë apo me sfonde me motive, mund të skanohen e procesohen së bashku pa qenë nevoja për ndryshimin e cilësimeve, duke ju kursyer kohë të çmuar.



BOARDROOM



SKANIM INTUITIV

"CaptureOnTouch Pro" ofron një ndërfaqe praktike duke përdorur komanda të thjeshta me bazë ikonash. Konfigurojini lehtësisht shkurtoret me butona pune për detyrat e shpeshta të skanimit, për t'i ruajtur e dërguar dokumentet drejt destinacioneve të ndryshme, duke përfshirës shërbimet e resë kompjuterike. Skanoni e veçoni automatikisht grupe dokumentesh në skedarë të veçantë, duke përdorur mënyra të ndryshme, mes të cilave njohje zonale germash, barkodesh dhe kodesh 2D. Nxirrni skedarë indeksesh të dhënash për integrim më të lehtë në ciklet ekzistuese të punës dhe në sistemet e menaxhimit të dokumenteve.

SIGURI E RRRITUR



Sigurohuni që skanerin ta hapin vetëm personat e autorizuar me aktivizim të thjeshtë të pajisjes me 4-PIN. Duke e përdorur skanerin DR-S150 së bashku me softuerin "CaptureOnTouch Admin Server", përdoruesit mund të identifikohen me "Active Directory" duke vendosur kredencialet e tyre në panelin e skanerit ose duke përdorur një kartë inteligjente me lexuesin opsional NFC.

KOSTO TË ULURA OPERATIVE INFORMATIKE

Me softuerin "CaptureOnTouch Admin Server", administratorët e sistemit informatik mund të konfigurojnë dhe menaxhojnë në formë të centralizuar apo nga distanca sisteme shumëflotëshe skanerësh, si dhe profilet e skanimeve sipas përdoruesit - duke kursyer kohë dhe duke pakësuar gabimet.

MJETI I MENAXHIMIT DR

Mjet praktik menaxhimi qendror për të mbështetur biznesin tuaj dhe mjedisin e përdoruesit. Mjeti i menaxhimit të skanerit DR është një metodë efikase për të monitoruar dhe shpërndarë cilësime në të njëjtën kohë për një numër të madh skanerësh në organizatë. Ai mund të shkarkohet nga faja jonë e internetit të Canon.



Canon

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PRODUKTIN

Tipi
Njësia e sensorit të skanimit
Rezolucioni optik
Burimi i dritës
Ana e skanimit
Ndërfaqja
Përmasat (gjër.xlart.)
Pesha
Nevojat për energji
Konsumi i energjisë
Mjedisi i përdorimit

Skaner tryeze me fletëmbajtëse
Sensor linje "CMOS CIS 1"
600dpi
LED RGB
Para/mbrapa/dyanëshe
USB 3.2 Gen1x1/USB 2.0, IEEE802.11b/g/n, 10Base-T/100Base-TX/1000Base-T
Sirtarët të mbyllur: 291x247x242 mm
Sirtarët të hapur: 291x600x378 mm
Afro 3,3 kg
AC 100-240 V (50/60 Hz)
Skanim: 22.5 W e poshtë
Modaliteti pasiv: 3.4 W e poshtë
Kur është i fikur: 0.1 W ose më pak
10 - 32,5°C
Lagështia: 20-80% relative

SPECIFIKIMET E SKANIMIT

Bardhezi
Ngjyra
Rezolucioni në dalje
Modaliteti në dalje
Cikli i këshilluar ditor i punës

45 fq/min / 90 ipm
45 fq/min / 90 ipm
150 x 150dpi, 200 x 200dpi, 240 x 240dpi, 300 x 300dpi, 400 x 400dpi, 600 x 600dpi,
Njëngjyrësh (Active Threshold, Black & White, Përhapja e gabimeve, Advanced Text Enhancement, Advanced Text Enhancement II),
Shkallëzim grije 8-bitësh (256 shkallë), Ngjyra 24-bitëshe
Afro 4000 skanime

SPECIFIKIMET PËR DOKUMENTET

Gjerësia
Gjatësia
Trashësia
Modaliteti i dokumenteve të gjata
Skanimi i kartëvizitave
Skanimi i kartave plastike
Skanimi i pasaportave
Ndarja e letrës
Kapaciteti i vetëmbushësës

50,8-216 mm
54-356 mm
20-209 g/m² (0,04-0,25 mm)
3000 mm maks.
Përmasat: 50x85 mm e lart
Trashësia: më pak se 0,45 mm
Përmasat: 54x86 mm
Trashësia: më pak se 1,4 mm
(Mbështeten kartat me relief)
Deri në 4 mm trashësi (me fletën mbajtëse)
Metoda me rul ngadalësues
60 fletë (80 g/m²)

VEÇORITË E VEÇANTA

Modul barkodi (vetëm në "Windows"), modul kodi 2D (vetëm në "Windows"), vetëpikasja e përmasave të faqes, drejtim, korrigjim 3-përmasor i ngjyrave, skartim ngjyrash (RGB), përmirësim ngjyrash (RGB), vetëpikasja ngjyrash, prerje të hijezimeve, MultiStream, cilësime të kalibrueshme të gamës, anashkalim i faqeve bosh, modalitet albumi, caktim i zonës së skanimit, ndarje në grupe me fletë të bardha ose kod të posaçëm, reduktim të errësimeve (vetëm në "Windows"), parandalim të tejkalimit të kontureve/heqje sfondi, rregullim kontrasti, lënim sfondi, prerje e hijeve, vetëcaktim rezolucioni, çlirim mbushjeje dyshe, pikasje mbushjeje dyshe (sensor me ultratinguj, sipas gjatësisë)

PROGRAMET E PËRFSHIRA KOMPJUTERIKE

Windows OS
Mac OS
Pjesët e konsumit

Draiver ISIS / TWAIN
CaptureOnTouch Pro
CaptureOnTouch JobTool
Wireless Connection Setup Tool
CaptureOnTouch Admin Server (vetëm me shkarkim)
CaptureOnTouch Admin Tool (vetëm me shkarkim)
Mjeti i menaxhimit DR (vetëm me shkarkim)
Drejtimes TWAIN për Mac
CaptureOnTouch
CaptureOnTouch Job Tool
Wireless Connection Setup Tool (të gjitha me shkarkim)

PJESËT E KONSUMIT

Komplet rulesh ndërrimi, fletëmbajtëse pasaporte, Fletë mbajtëse A4

AKSESORËT

Sirtar mbushjeje me NFC
A4 Flatbed Scanner Unit 102
A3 Flatbed Scanner Unit 202

Klauzolat

Shpejtësia e skanimit mund të ndryshojë në varësi të mjedisit kompjuterik, parametrave të skanerit dhe faktorëve të tjerë.
Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.
Vizitoni faqen e internetit të Canon për më shumë informacion.

Aksesorët




A4 Flatbed Scanner Unit 102



A3 Flatbed Scanner Unit 202

Jepuni drejtim përjashtimeve me opsionin e shtrirë

Skanoi libra të lidhur, ditare dhe materiale të brishta duke shtuar Flatbed Scanner Unit 102 për dokumente deri në formatin A4, ose Flatbed Scanner Unit 202 për skanime në formatin A3. Me lidhjen përmes USB-së, këta skanerë me shtraz të sheshtë punojnë më së miri me skanerët imageFORMULA në formë paralele që ju mundëson zbatimin e optimizimeve të njëjta të figurës në çfarëdo skanimit.



Sirtar mbushjeje me NFC

Për të mbështetur autentikim të shpejtë e të lehtë të përdoruesit duke përdorur kartë afërsie. Autentikimi i përdoruesit me NFC kryhet së bashku me softuerin "CaptureOnTouch Admin" duke regjistruar numrin e serisë së kartës së afërsisë tek atributi i përdoruesit në "Active Directory". Lloji i mbështetur i kartës IC është "Mifare (Type A)" dhe "FeliCa".

Seti i zhvillimit programatik (SDK)

Setet dhe mjetet e zhvillimit programatik ofrohet përmes Canon Developer Programme. Për t'u regjistruar për programin:

- Vizitoni faqen e regjistrimit - <https://developers.canon-europe.com/developers/s/login/SelfRegister>
- Nëse keni ndonjë problem gjatë regjistrimit, ju lutemi të kontaktoni me administratorin e CDP në adresën cdp-admin@canon-europe.com